

**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**GAZETA SHQIP ONLINE SHPK**

Sot më datë 25.01.2019 në Tiranë në adresën Rruga 17 Nëntori, janë të pranishëm personalisht ortakët shoqërisë në themelim Gazeta Shqip Online ShPK:

- 1) *Z. Endrit Habilaj, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 10.03.1988, banues ne Tiranë, i identifikuar me numër personal I80310077T*  
dhe
- 2) *Zj. Ornella Gjoka, shtetase shqiptare, lindur ne Fier, më 13.01.1981, banuese në Tiranë, e identifikuar me numër personal I15113109C*

Ortakët e shoqërisë në themelim deklarojnë me vullnetin e tyre të lirë dhe të pa vesuar, pranimin e dispozitave dhe parashikimeve në vijim, hartimin e Statutit në themelim "Gazeta Shqip Online" në bazë të ligji për tregtarët dh shoqëritë tregtare n. 9901/2008 dhe hartojnë Statutin për sa vijon:

**Neni 1**

**Emri i Shoqërisë**

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është emërtuar "Gazeta Shqip Online".
2. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB") me emrin "Gazeta Shqip Online" ("Shoqëria").

**Neni 2**

**Selia e Shoqërisë**

1. Shoqëria Gazeta Shqip Online Shpk e ka selinë ligjore në Tiranë, Kashar, Mezez, Njësia Administrative Kashar, Rruga 17 Nëntori, Godina Nr.20, Kati 2.
2. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë përtransferimin e selisë së Shoqërisë, ose themelin apo mylljen e degëvedhe/ose zyrave të përfaqësimit apo zyra administrative brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.



### Neni 3

#### Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 3.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të saj pranë QKBpër një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.2. Shoqëria fiton personalitet juridik nga momenti i regjistrimit në QKB Tiranë.

### Neni 4

#### Objekti i Shoqërisë

Shoqëria ka për objekt:

Veprimtari në fushën e mediave te shkruara dhe online, hapjen dhe mirëmbajtjen e faqeve te internetit.

Botimi, prodhimi dhe shpërndarja e revistave gazetave, fletëpalosje, printime te ndryshme, reklama, banner, sticker dhe materialeve te tjera te lejuara me ligj.

Konsulencë ne fushen mediatike dhe marketing, media buying.

Auditime e trajnime për gazetarinë multimediale për krijimin e website.

Kryerje komisioni për llogari apo ne emër te shoqërive te tjera qe kane interes për këtë lloj shërbimi.

Përveç kësaj ne përputhje me legjislatacionin shqiptar, shoqëria mund te kryeje çdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe është rezultat ose lidhet me objektivin e mësipërm.

Për arritjen e qëllimit te mësipërm, shoqëria mund te kryeje çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe te paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshem ose i nevojshëm ne mënyrë qe te ushtrohet objekti i shoqërisë.

Shoqëria mund te hape dege, filiale apo zyra përfaqësie, si dhe mund te marre pjese ne shoqëri te tjera, qe ekzistojnë ose do te krijojen ne të ardhmen.

### Neni 5

#### Kapitali i Shoqërisë

- 5.1. Kapitali fillestare i Shoqërisë është ALL 100.000 (njëqindmijëLekë).Kapitali i shoqërisë konsiston në2 (dy) kuotatë cilat zotërohen nga ortakët si vijon:

- 50% e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga ortaku Endrit Habilaj;
- 50% e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga ortaku Ornella Gjoka.

Kapitali fillestare i Shoqërisë mund të zmadhohet apo zvogëlohet dhe është tërësisht ilikuidueshëm dhe i nënshkrueshëm.

- 5.2 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme e miratuar me shumicën e kualifikuar të parashikuar nga Statuti.

Në rast të një zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit në proporcione kuotën që zoterojnë, me mënyrën e parashikuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Kurdoherë që një ose më shumë ortakë të heqin dorë plotësisht ose pjesërisht nga e drejta për të nënshkruar përritjen e kapitalit përkatesë ose që nuk e ushtrojnë këtë të drejtë në kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar në rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi i kapitalit të mbetur i paprekur do tu ofrohet si mundësi ortakëve të tjerë në mënyrë proporcionale me kapitalin që zoterojnë. Një zmadhim i mundshëm i kuotave të kapitalit të panënshkruar do të mund tu ofrohet për të palëve të treta të interesuara, përvèç kur parashikohet ndryshe nga vendimi i Asamblesë së Përgjithshme. Palët e treta të interesuara në blerjen e aksioneve në kapitalin e shoqërisë duhet të janë me pëlqimin e ortakëve dhe për këtë arsy propozimi i tyre i blerjes duhet të jetë i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme. Në rast të një nënshkrimi të pjesës së kapitalit ajo do të konsiderohet në të gjitha rastet në rritje për pjesën e nënshkruar nga ortakët.

- 5.3. Shoqëria mund të zgjedhë kapitalin pas një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të miratuar me shumicë të cilësuar Statut. Në çdo rast, kapitali nuk do të reduktohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

Zvogëlimi i kapitalit mbështetet nga çdo ortak në proporcione me pjesën e mbajtur në Shoqëri.

- 5.4. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar i saj, nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe nga pasuri të tjera të konsideruara ose që do të konsiderohen si të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së Shoqërisë.
- 5.5. Kuotat e kapitalit derdhen në bankë nga ortakët, në llogarinë rrjedhëse në emër të Shoqërisë.
- 5.6. Kapitali fillestar është nënshkruar tërësisht nga Ortakët e Shoqërisë.
- 5.7. Ortakët kanë të drejtën të térheqin fondet e depozituara si kapital fillestar të Shoqërisë, në rastin në të cilin Shoqëria nuk regjistrohet në QKB brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e depozitimit të fondit.



## Neni 6

### Transferimi i Kuotave

- 6.1. Transferimi i kuotave është i vlefshëm ndaj ortakëve të Shoqërisë si me akt midis të gjallëve ashtu dhe me trashëgimi, vetëm në rast se rezulton se janë respektuar dispozitat e këtij neni.
- 6.2. Në rast transferimi të kuotave midis të gjallëve me akt, ortakëve i takon e drejta e parablerjes të kuotave të shoqërisë. Ortaku shitëssi fillim duhet t'i bëj një ofertë ortakeve të tjerë me letër rekomande, në të cilën të përcaktojë çmimin e kërkuar për shitjen e kuotëssë tij. Në këtë rast secili nga ortakët, në proporcion me pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë, gëzon të drejtën e parablerjes.
- 6.3. Në rast mosmarrëveshjesh mbi çmimin e kërkuar, me kërkesë të palëve të interesuara, çmimi do të përcaktohet nga një ekspert kontabël i miratuar me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Ortakëve, i cili do të përcaktojë çmimin e shitjes në bazë të vlerës reale të kuotave.
- 6.4. Në rast mosmarrëveshjeje mbi emërimin e ekspertit kontabël, i cili do të emërohet me shpenzimetë secilës palë, me kërkesë të palës së interesuar do të zgjidhet nga gjykata e vendit ku ka selinë shoqëria.
- 6.5. Eksperti duhet të kryejë vlerësimet sipas kritereve dhe mënyrave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
- 6.6. Pas vlerësimit të kuotave nga ana e ekspertit, si shitësi por ashtu edhe blerësi, kanë të drejtë të tërhiqen përkatësisht nga shitja dhe blerja. Në këtë rast shpenzimet e ekspertit do të jenë në ngarkim tëpalës që tërhiqet.
- 6.7. Ortaku shitës i kuotave duhet t'i transferojë këto të fundit me akt të shkruar ortakëve blerës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit dhe në rast të vlerësimit të bërë nga eksperti kontabël, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e vlerësimit.
- 6.8. E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet brenda një periudhe 30 (tridhjetë) ditoreduke filluar nga data e njoftimit të ofertës ose brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e përcaktimit të çmimit nga ana e ekspertit kontabël të emëruar. Pasi kanë kaluar afatet e mësipërme, shitësi ka të drejtën të transferoje tek palë të treta kuotën e tij.
- 6.9. Transferimi i kuotave për shkak trashëgimie ndaj trashëgimtarëve të të ndjerit është i kufizuar me dhënien e miratimit e ortakëve të mbledhur në asamblenë e përgjithshme. Në rast kundërshtimi të ortakëve për transferimin e kuotave drejt trashëgimtarëve të të ndjerit, çmimi i shitjes do të caktohet sipas procedurave për transferimin me akt midis të gjallëve si më sipër.

## Neni 7

### Fitimet e Shoqërisë

- 7.1. Fitimet e Shoqërisë i takojnë ortakëve të saj.
- 7.2. Asambleja vendos sipas ligjit për ndarjen ose ri qarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrat.

## Neni 8

- 8.1. Shoqëria do të përdorë dhe disponoje pasurinë e saj të akumuluar. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, materiale ose jo materiale, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë sëakumuluar tek të tretët.Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit në fuqi.

## Neni 9

- 9.1. Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

## Neni 10

### Drejtimi dhe administrimi i Shoqërisë

- 10.1. Bëjnë pjesë në detyrat dhe kompetencat e ortakëve të mbledhur nëAsamblenë e Përgjithshme të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuar në ketë Statut. Ndër këto detyra përfshihen:
  1. ndryshimi i aktittë themelimit statutit;
  2. miratimi i buxhetit vjetor, tëraporteve të administrimit, të inventarit, të bilancit dhe llogarive vjetore;
  3. emërimi e shkarkimi i administratorëve, qofshin ortakë ose jo, dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se qoftë për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do të jetë e domosdoshme të jepet shprehimisht motivi;
  4. miratimi i kredive dhe garancive;
  5. miratimi i tarifave për shërbimet që kryen Shoqëria;
  6. përcaktimi i formës së vulës dhe të markës sëShoqërisë;
  7. zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit tëShoqërisë;

8. mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
9. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve te ecurisë se veprimtarisë se Shoqërisë;
10. vendimi lidhur me krijimin apo mbylljen e degëve, zyrave të përfaqësimit ose agjencive të Shoqërisë;
11. vendimi për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
12. vendimi për fillimin apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore në të cilën është e përfshirë Shoqëria, duke autorizuar administratorin e Shoqërisë për të vepruar;
13. vendimi për emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar apo të konsulentëve të tjera, qofte persona fizikë apo juridikë;
14. vendimi për ndarjen e kotave dhe për anulimin tyre;
15. vendimi për miratimin dhe ndryshimin e procedurës për mbledhjen e asamblesë;
16. vendimi për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të Shoqërisë;
17. vendimipër shitjen e kuotave të Shoqërisë;
18. vendime për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
19. marrjen e çdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër.

## Neni 11

### Asambleja e Përgjithshme

- 11.1. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit.
- 11.2. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakeve me shkresë ose, sipas zgjedhjes së administratorit, nëpërmjet postës elektronike. Adresat elektronike email të ortakëve regjistrohen në bazën e të dhënave të Shoqërisë.
- 11.3. Njoftimi për mbledhjen e asamblesë duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 11.4. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit të lartpërmendur, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortaket janë dakord për të marre këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit.
- 11.5. Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbale. Prosesverbali



duhet të mbajë datën, vandin, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të mbledhjes dhe Sekretarit që mban procesverbalin, i cili mund të jetë edhe jo ortak apo jo punëmarrës i Shoqërisë, si dhe rezultati i votimit dhe duhet të nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari. Procesverbalit i bashkëlidhet lista e të pranishmëve dhe thirrja.

- 11.6. Pjesëmarrja apo votimi në Asamblenë e Përgjithshme mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike në mënyrën e parashikuar në ligj. Prosesverbalit i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të Shoqërisë nën kujdesin e administratorit.
- 11.7. Asambleja e përgjithshme mund të mblidhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në ketë rast vendimet e asamblesë së përgjithshme të marra jashtë territorit te Republikës së Shqipërisë, do t'i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri dhe duhet të jenë në përputhje me parashikimet e këtij statutit për sa i takon kuorumi dhe shumicës në marrjen e vendimeve.

- 11.8. Asambleja e Përgjithshme, përveç rasteve parashikimeve të nenit 11.9 të këtij Statuti, vendos me votën pro të shumicës së ortakëve, nëse ortakët që marrin pjesë në mbledhje me të drejtë vote përfaqësojnë më shumë se 30% (tridhjete për qind) të kapitalit të shoqërisë.
- 11.9. Asambleja e Përgjithshme vendos me 75% (shtatëdhjetepesë për qind) të votave të ortakëve, nëse ortakët që marrin pjesë me të drejtë vote përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë. Çështjet për të cilat kërkohet shumica e kualifikuar janë:
  - a) Ndryshimet e Statutit;
  - b) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit;
  - c) Shpërndarja e fitimeve;
  - d) Riorganizimi, prishja dhe likuidimi i Shoqërisë dhe degëve të saj.

## Neni 12

### 12.1. Administratorët e Shoqërisë janë:

- 1) *Z. Endrit Habilaj, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 10.03.1988, banues ne Tiranë, i identifikuar me numër personal I80310077T*  
*dhe*
- 2) *Zj. Ornella Gjoka, shtetase shqiptare, lindur ne Fier, më 13.01.1981, banuese në Tiranë, e identifikuar me numër personal I15113109C*

- 12.2. Administratorëtë Shoqërisë i ushtrojnë kompetencat e tyre bashkërisht për kryerjen e veprimtarivetë administrimit te zakonshëm të Shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme në përpunje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 12.3. Administratorët emërohen për një afat 5 (pesë) vjeçar duke filluar nga data e emërimit, me të drejtë riemërimi nga asambleja e ortakëve.
- 12.4. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të revokojë administratorin para mbarimit të mandatit. Administratori ka të drejtë të japë dorëheqjen e parakohshme, përpara mbarimit te mandatit, me njoftim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme sipas procedurave të parashikuar në ligj.
- 12.5. Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë edhe më shumë se një administrator, të çfarëdo kombësie dhe te jashtëm për Shoqërinë. Në rastin e emërimit te një apo me shume administratoreve ne fuqi, secili nga administratorët mund të ushtrojë të gjitha tagrat e përfaqësimit dhe të firmës ashtu si rezultojnë në aktin e emërimit të tyre. Secili nga ato do të jetë individualisht përgjegjës për përmbrushjen e funksioneve te dhëna nga ligji për administratorin dhe do ti komunikojë të tjerëve ose administratorit tjeter veprimet nga ai të kryera.

### Neni 13

- 13.1. Administratoret kryejnë detyrat e përcaktuara nga Ortakët e Shoqërisë në këtë Statut dhe të gjitha ato detyra të parashikuara dhe të rregulluara me ligj. Ndër këto përshihen detyrat e renditura më poshtë.
  1. Të veprojë dhe të nënshkruejë në emër të Shoqërisë.
  2. Të hartoje rregulloren e brendshme të Shoqërisë dhe një plan biznesi për vitin finanziar, që do të miratohet në Asamblenë e Përgjithshme.
  3. Të marrë vendime lidhur me kreditë që do të merren dhe dhënen e garancive.
  4. Të përpunojë dhe të paraqesë për miratim në asamblenë e përgjithshme raporte për sezonin e aktivitetit të shoqërisë dhe të bilancit të mbylljes së aktivitetit financiar të vitit paraardhës, sipas asaj që parashikohet në ligj.
  5. Të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme.
  6. Administratorët janë përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tretëve për shkeljet e ligjit apo të normave të statutit që mund të ndodhin gjatë sezonit së aktivitetit, sipas legjislacionit shqiptar.
  7. Të kryejë të gjitha aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.

8. Të përfaqësoje Shoqërinë.
9. Të kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë me korrekëtësi dhe saktësi.
10. Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
11. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
12. Të raportojë përpala asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rendësi të veçante për veprimtarinë e Shoqërisë.
13. Të emërojë financierë e konsulentë për problemet e shoqërisë. Financieri nxjerr rregullisht indikatorët financare të tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të Shoqërisë.
14. Të mirë administrojë Shoqërinë.
15. Të lidhë marrëveshje me të tretë në kufijtë e objektit të aktivitetit të Shoqërisë dhe të kompetencave të përcaktuara nga ortakët.
16. Të zbatojë rregulloren e brendshme të Shoqërisë.
17. Të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara Shoqërisë nga veprimet e tij.
18. Të shpërblehet për punën që kryen sipas marrëveshjes me ortaket themelues.
19. Të informohet dhe të bëjë propozime për çfarëdolloj gjëje që e vlerëson si të rëndësishme për shoqërinë.
20. Të kryejë të gjitha veprimet bankare në lidhje me llogarinë e shoqërisë.
21. Administratorët kanëtë drejtë dhe detyrë të thërrasin asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitave të përcaktuara në nenet 12 dhe 13 të këtij statuti dhe të ligjit aty ku nuk parashikohet shprehimisht në statut.

#### Neni 14

##### Të Drejtat e Shoqërisë

14.1. Shoqëria ka të drejtë:

1. të kryejë veprimtari në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë;
2. të siguroje pasurinë e vet;
3. të marre kredi në lekë dhe në valutë nga Bankat vendase ose të huaja në bazë të rregullave ligjore;



4. të përfitoje nga favoret që i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tativit e tij;
5. të investoje kudo në Shqipëri, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
6. të punësoje punëtore, vendas ose të huaj;
7. të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

#### Neni 15

##### Detyrat e Shoqërisë

Shoqëria ka përdetyrë:

1. të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
2. të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
3. të sigurojë punonjësit e saj;
4. të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
5. të pajiset me leje/autorizime të mundshme, nëse kërkojnë nga ligji, për të zbatuar objektin e veprimtarisë se saj;
6. të respektojë standardet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

#### Neni 16

##### Marrëdhëni ekonomike – financiare të Shoqërisë

- 16.1 E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.

#### Neni 17

- 17.1. Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni finanziar, në bazë të cilit, brenda datës 31 mars të çdo viti nxirret bilanci vjetor i Shoqërisë.

#### Neni 18

- 18.1. Viti finanziar fillon çdo vit më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të të njëjtë vit.

#### Neni 19

- 19.1. Shoqëria mban llogarinë e saj në Bankë. Llogaritë mbahen në Lekë dhe/ose Euro dhe pasqyrohen në librat kontabël përkatës.



### Neni 20

- 20.1 Nga fitimet e realizuara gjatë vitit finanziar, Shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjanë 5% të fitimit, me të cilin krijohet fondi "Rezervë e domosdoshme", derisa ky fond të arrijet masën 10% të kapitalit themeltar.

### Neni 21

#### Dispozita të veçanta

- 21.1. Shoqëria ka vulën e saj me përmasa te zakonshme, të realizuar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe mund të ketë një markë të vetën. Në rast të krijimit të një faqe interneti, mund të deklarohet në mënyrë vullnetare në QKB.

### Neni 22

#### Shndërrimi

- 22.1. Shndërrimi i Shoqërisë në shoqëri të llojeve të tjera, mund të behët me vendim të ortakeve themelues sipas mënyrave të parashikuara në ligj.

### Neni 23

#### Prishja e Shoqërisë

- 23.1 Shpërbërja e shoqërisë, mund te vije për shkaqet e parashikuara ne nenin 99 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 dhe për arsyet si me poshtë:

- kurmbaronkohëzgjatjaeparashikuarnëthemeliminesaj;
- mevendimtëasamblesëspërgjithshme;
- mehapjeneproceduravetëfalimentimit;
- nësenukkakryerveprimitartregtarepërdyyvjetdhenukeshtënjoftuarpezullimi  
veprimitarisënëpërputhjemepikën3tënenit43tëligjitnr.9723,datë3.5.2007"PërQe  
ndrën KombëtaretëRegistrimit";
- mevendimtëgjykatës;
- humbja e kapitalit te shoqërisë;

Ne këto raste, ortaket e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose me shume likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë se Shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizike e juridike, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet qe ka shoqëria ndaj personave të tretë.



- 23.2. Në rast se fondet e disponueshme, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkoje ortakeve themelues të Shoqërisë që të derdhë tërësisht kuotat që u takojnë.

Neni 24

Ligji i aplikueshëm dhe Juridiksioni

- 24.1 Të gjitha konfliktet që mund të lindin midis ortakëve të Shoqërisë, midis ortakëve dhe Shoqërisë, midis Shoqërisë dhe administratorit do ti nënshtronen për zgjidhje gjykatës kompetente të Republikës se Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.

Neni 25

- 25.1. Ky statut përpilohet ne 2 (dy) ekzemplare në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet rregullisht nga ortakët.

\*\*\* . \*\*\*

Nënshkruar në Tiranë më datë 25.01.2019

Ortakët e shoqërisë Gazeta Shqip Online Shpk

Endrit Habilaj   
Emër, mbiemër, firmë

Danele Gjolaj   
Emër, mbiemër, firmë